



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 8 tetor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Urdhër mbi Kërkesën sipas Rregullës 151

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Methju Haling

Valeria Boliçi

Xhejms Pejs

Zyrës së Mbrojtjes

Mbrojtësit të Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bauden

Mbrojtësit të Nasim Haradinajt

Tobi Kadman

Karl Bakli



TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në përputhje me nenin 40(2) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullën 151(6) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 8 shtator 2021, gjatë Konferencës Përgatitore për Gjykim, pasi dëgjoji palët lidhur me çështjen, Trupi Gjykues miratoi kërkesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS") për përfshirjen e W04866-ës në listën e dëshmitarëve të saj.¹
2. Më 24 shtator 2021, Arianit Koci ("z. Koci"), avokati që ishte lejuar të ishte i pranishëm gjatë intervistës së W04866-ës si dëshmitar me kërkesë të këtij të fundit, i dërgoi një kërkesë ZPS-së që të ishte përfaqësuesi ligjor i W04866-ës sipas rregullës 151(6) të Rregullores ("Shtojca").²
3. Më 27 shtator 2021, ZPS-ja i dërgoi Trupit Gjykues për shqyrtim kërkesën e z. Koci për të përfaqësuar W04866-ën gjatë dhënies së dëshmisë ("Kërkesa").³
4. Më 29 shtator 2021, Trupi Gjykues lëshoi një urdhër ku: (i) urdhëroi Administratoren ta riklasifikonte Kërkesën si konfidenciale; (ii) urdhëroi Mbrojtjen t'i përgjigjej Kërkesës, nëse dëshironte, deri më 6 tetor 2021; dhe (iii) informoi ZPS-në se nuk do të lejohej të bënte kundërpërgjigje.⁴
5. Mbrojtja nuk dorëzoi përgjigje.

¹ Transkripti, 8 shtator 2021, f. 707, rreshtat 22-25.

² F00327/A01, ZPS, *Shtojca 1 e Transmetimit të Kërkesës sipas Rregullës 151– Email i Arianit Kocit Dërguar ZPS-së ("Shtojca")*, 24 shtator 2021, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

³ F00327, ZPS, *Transmetim i Kërkesës sipas Rregullës 151, me një Shtojcë Rreptësisht Konfidenciale dhe Ex Parte ("Kërkesa")*, 27 shtator 2021, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁴ F00336, Trupi Gjykues, *Urdhër për Riklasifikimin dhe Përgjigjet ndaj Transmetimit sipas Rregullës 151 ("Urdhri")*, 29 shtator 2021, konfidencial.



II. PARASHTRIMET

6. Ndërkohë që përsërit mendimin e saj se nuk ka arsye të besohet se W04866 është përgjegjës për ndonjë vepër penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara ("DHS"), ZPS-ja nuk kundërshton që W04866-ës t'i jepen garanci lidhur me vetinkriminimin, ose që nga Lista e Mbrojtësve t'i caktohet z. Koci si mbrojtës në kuadrin e dëshmisë së tij të ardhshme.⁵

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

7. Sipas rregullës 151(3) të Rregullores, në qoftë se trupi gjykues vendos ta detyrojë dëshmitarin të dëshmojë, pasi të ketë kërkuar *ex parte* mendimin e Prokurorit të Specializuar, trupi gjykues mund të përcaktojë se para dhënies së dëshmisë dëshmitarit i duhet dhënë garanci në lidhje me vetinkriminimin.

8. Sipas rregullës 151(6) të Rregullores, në përputhje me rrethanat, trupi gjykues mund të urdhërojë Administratoren t'i caktojë dëshmitarit një mbrojtës me qëllim që dëshmitari të mund të marrë këshilla juridike në lidhje me efektin e dëshmisë së vet.

IV. DISKUTIM

9. Për sa u përket garancive në bazë të rregullës 151(3) të Rregullores, Trupi Gjykues merr parasysh parashtrimet e ZPS-së se nuk ka arsye të besohet se W04866 është përgjegjës për ndonjë vepër penale brenda juridiksionit të DHS-së. Bazuar në sa më sipër dhe në mungesë të ndonjë sugjerimi të kundërt nga ana e Mbrojtjes, Trupi Gjykues gjykon se dhënia e garancive lidhur me vetinkriminimin sipas dispozitës në fjalë është sa e panevojshme aq edhe e parakohshme në këtë fazë.

10. Për sa i përket kërkesës së z. Koci për të përfaqësuar ligjërisht W04866-ën në bazë të rregullës 151(6) të Rregullores, Trupi Gjykues vëren se: (i) z. Koci është pranuar në

⁵ Kërkesa, para. 2 që i referohet Transkriptit, 8 shtator 2021, f. 692.



Listën e Mbrojtësve në përputhje me rregullat;⁶ (ii) ai ka qenë i pranishëm gjatë intervistës së W04866-ës me kërkesë të këtij të fundit;⁷ (iii) ZPS-ja nuk kundërshton që z. Koci të caktohet mbrojtës i W04866-ës në kuadrin e dëshmisë së tij të ardhshme;⁸ dhe (iv) Mbrojtja nuk e ka kundërshtuar Kërkesën. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se është e përshtatshme që z. Koci të caktohet mbrojtës i W04866-ës me qëllim që dëshmitari të mund të marrë këshilla juridike lidhur me efektin e dëshmisë së tij të ardhshme në këtë proces gjyqësor. Gjithashtu, Trupi Gjykses gjykon se është e përshtatshme që z. Koci të jetë i pranishëm në sallën e gjyqit ose me videolidhje gjatë dhënies së dëshmisë së W04866-ës.

V. VENDIM

11. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a. **MIRATON** kërkesën e z. Koci;
- b. **URDHËRON** Administratoren ta caktojë z. Koci si mbrojtës të W04866-ës në kuadrin e dëshmisë së tij të ardhshme në këtë çështje gjyqësore; dhe
- c. **AUTORIZON** praninë e z. Koci në sallën e gjyqit ose me videolidhje gjatë dhënies së dëshmisë së W04866-ës.

/nënshkrimi/

Gjykatësi Çarls L. Smith, III
Kryegjykatës

E premte, 8 tetor 2021
Në Hagë, Holandë.

⁶ *Shih* Faqen e internetit të Dhomave të Specializuara të Kosovës, [Listë e Mbrojtësve](#), nr. 96.

⁷ Kërkesa, para. 1.

⁸ Kërkesa, para. 2.



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA